



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:090879
Datë: 24.10.2024
Numri i dokumentit: 06345304

Ac.nr.3883/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Hunaida Pasuli, kryetare e kolegjit Halide Reka dhe Burim Shala, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit M. M. nga fshati L.e P., Komuna e P., të cilin me autorizim e përfaqëson av. B. Sh. nga P., kundër të paditurës Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit gjatë punës, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.1080/2020, të datës 03.04.2023, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 22.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.1080/2020, i datës 03.04.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.1080/2020,të datës 03.04.2023, ka vendosur si në vijim: ***I.APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit M. M. nga fshati L. Komuna e Prizrenit dhe DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim ditor-shujtave për vitin 2017 deri 2021, t'ia paguaj paditësit për 648 ditë pune shumë prej 1,296.00 € (njëmijë e dyqind e nëndëdhjetë e gjashtë euro), me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e paraqitjes së padisë (19.12.2021) e gjerë në pagesën definitive, në afatin prej 7 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.II. DETYROHET e paditura që t'ia paguajë paditësit shpenzimet procedurale dhe atë në lartësi prej 124,00 € në afat prej 7 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.***

Kundër këtij aktgjykimi e paditura, përmes të autorizuarit të saj, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkëljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit të aprovoj ankesën si të bazuar, të ndryshoj aktgjykimin e ankimuar dhe të hedhet poshtë padia e paditësit ose të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar dhe ta prish dhe çështjen t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar paditësi.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, përmes të autorizuarit të tij, me datë 03.08.2020 ka parashtruar padi për kompensimin e shujtave ditore për ushqim në punë, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit. Në padi, ka theksuar se paditësi është në marrëdhënie pune në Sh.F.M.U “.. M” në fshatin L. e P., Komuna e Prizrenit, në kuadër të Drejtorisë Komunale të Arsimit në Prizren. Po ashtu ka theksuar se gjatë vitit 2017-2021 ku ka punuar 5 ditë pune në javë ose 648 ditë pune, andaj ka kërkuar që e paditura t’ia kompensojë shpenzimet e ushqimit për ditët e pranisë në punë dhe atë 2 euro për çdo ditë të paraqitur në punë, respektivisht shumën prej 1,296.00 €, me kamatë ligjore, si dhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas përgjigjes në padi nga e paditura dhe pas vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës gjykata në bazë të nenit **152 të LPK-së**, pa shqyrtim kryesor të çështjes, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, C.nr. C.nr.1080/2020, i datës 03.04.2023, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se në mes palëve ndërgjyqës nuk ishte kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, në Sh.F.M.U “.. M..” në fshatin L. e P., Komuna e Prizrenit. Gjykata përmes vërtetimeve të lëshuara nga e paditura me numër të referencës 41/20 e datës 15.06.2020 dhe vërtetimit me numër 84/2021 e datës 01.12.2021 mbi ditët e prezencës në punë, për paditësin vërtetoi faktin se gjatë vitit 2017-2021 ku ka punuar 648 ditë pune. Gjykata kishte gjetur se e paditura ka pasur për detyrim që paditësit si punëtorë i arsimit t’ia kompensoj shujtat ditore gjatë punës, konform detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive, ditët e punës për paditësin, të vërtetuara nga vetë punëdhënësi, në totalin prej 648 ditë pune, gjykata i ka shumëzuar me shumën prej 2 €, duke i njohur shumat si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar nenit 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit, vendimin mbi kamatën e ka bazuar në nenin 378 dhe 382 të LMD-së ndërsa vendimin mbi shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në nenin 449 dhe 452 dhe 453.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i

përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat janë pretenduar nga pala ankuese.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të t'paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Janë të paqëndrueshme pretendimet ankimore për shkelje të dispozitave nga neni 182 par. 2 pika o) të LPK-së, për faktin se një pretendim i tillë është paraqitur në mënyrë të gjeneralizuar vetëm duke u përmendur dispozitat pa specifikuar ndonjë rrethanë se ku konsiston shkelja e pretenduar e cila do e arsyetonte pretendimin e tillë ankimor.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike, se paditësi është në marrëdhënie pune Sh.F.M.U “.. M..” në fshatin L. e P., Komuna e Prizrenit, ndërsa në bazë të vërtetimit e lëshuar nga e paditura ka vërtetuar faktin se paditësi gjatë vitit 2022, ku ka punuar 158 ditë punë.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes si në aktgjykimin e ankimuar, në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale për arsye se me nenin 90 paragrafin 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve*”. Me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: a) nivel të vendit, b) nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes*“. Me paragrafin 3 të këtij neni, përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës*”. Me paragrafin 5 përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive...*”. Me nenin 35 paragrafin 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, përcaktohet se: “*Të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) Euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. ndërsa në nenin 2 par.1.2 të Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovë, parashihet se: “Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat - DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës...”, ndaj detyrimi për zbatimin e kësaj kontrate ka fuqinë ligjore.*

Gjykata e Apelit, mori parasysh edhe pretendimin ankimor lidhur me faktin se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për faktin se Kontrata Kolektive e Arsimit nuk është obligative për të paditurën, për arsye se nënshkruesit e kësaj kontrate siç janë MASHT-i, SBASHK-u dhe Ministria e Financave nuk janë angazhuar për zbatimin e dispozitave që ndërlidhen me implikimet financiare. Lidhur me këto pretendime, Gjykata e Apelit vlerëson se referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, rrjedh se obligimi për përmbushjen e të drejtave të të punësuarve të parapara me këtë Kontratë, përfshirë të drejtën për kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë i takon pikërisht punëdhënësit, që në rastin konkret i bie të jetë Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit. Në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj Kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditëses, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa bazuar.

Pretendimi ankimor se paditësja nuk i ka shtjerrë mjetet e brendshme juridike në procedurën administrative është i pa bazuar, pasi në rastin konkret kemi të bëjmë me kërkesë ku pretendohet një e drejtë e natyrës monetare dhe e cila buron nga dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit, që nuk kufizohet në kontest ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit, gjegjësisht nuk kemi të bëjmë me pretendim për anulimin e ndonjë vendimi me të cilin janë shkelur të drejtat nga marrëdhënia e punës, andaj nuk ekziston ndonjë pengesë që mbrojtja gjyqësore të kërkohet në mënyrë të drejtpërdrejtë përmes ushtrimit të padisë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore të palës së paditur, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për vendosje ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për kumatën e gjykuar është në përputhje me dispozitën e nenit 382 të LMD-së, ndërsa vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e nenit 449 dhe 452 dhe 453.1 të LPK-së.

Nga të lart cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragrafi 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.3883/2023, me datë 22.10.2024

Kryetarja e kolegjit
Hunaida Pasuli